



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P.191/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 05.06.2020 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:	Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e BOE “Almo Konstruksion” shpk & “K.Turja” shpk nga procedura e prokurimit “ <i>Procedurë e Hapur</i> ”, me nr.REF-49839-02-07-2020, me objekt ‘ <i>Zgjerimi i Rrugës Vendore, Aks Superstrada e Devollit- Ismail Qemali, Demir Progeri-Aks Rrg. Etem Osman Xhaci dhe Rehabilitim i Rrugeve Vendore Lagjia Nr. 2 dhe Lagjia Nr. 3</i> ’, me fond limit 83 333 963 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 27.03.2020 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Devoll.
Ankimues:	BOE “Almo Konstruksion” shpk& “K.Turja” shpk Lagjia: Zall Mner i Ri, Rruga Nacionale Kamëz Tiranë
Autoriteti Kontraktor:	Bashkia Devoll Lagjia Nr.1 Rruga “24 tetori” Nr.9, Bilisht, Devoll

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:**I***Vlerësimi paraprak*

1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 07.02.2020 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr.REF-49839-02-07-2020, me objekt “*Zgjerimi i Rrugës Vendore, Aks Superstrada e Devollit- Ismail Qemali, Demir Progeri-Aks Rrg. Etem Osman Xhaci dhe Rehabilitim i Rrugeve Vendore Lagjia Nr. 2 dhe Lagjia Nr. 3*”, me fond limit 83 333 963 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 27.03.2020 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Devoll.

II.2. Në datën 27.03.2020 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 17.04.2020 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- Almo Konstruksion& K.Turja	60,950,227.3	I skualifikuar
- NIEM&Artyka II	82,697,283.2	I kualifikuar

II.4. Në datën 17.04.2020 bashkimi i operatorëve ekonomikë “Almo Konstruksion” shpk & “K.Turja” shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave

- *Pas verifikimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit të parqitur nga BOE “ALMO KONSTRUKSION” SHPK & “K.TURJA” SHPK për të përmbushur KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT për kapacitetin teknik të kerkuara nga AK në këtë procedurë prokurimi për pikën 9.Ku Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 13 (trembedhjete) manovratore, 9 (nëntë) shofere, për të cilët duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmitë e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në list-pagesat e shoqërisë. konstaton se:*

BOE “ALMO KONSTRUKSION” SHPK & “K.TURJA” SHPK nuk plotëson kapacitetin teknik sipas pikës 9 të DST: 1. Mungojnë 5 (pese) manovratore, për të cilët duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmitë e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në list-pagesat e shoqërisë. Manvratore të paraqitur për kualifikim nga OE “ALMO KONSTRUKSION” SHPK 2-Gezim Laçi -DAP Nr.2066/Nr.serie 01641 e vlefshme deri 12.12.2024 për Automakiniste,figuron në list-pagesat e shoqërisë me Kodin Nr.8332.14 (Shofer kamioni) të Profesionit sipas (LKP)

Nuk përmbush kriterin e kualifikimit kerkuar nga AK në DST si manovrator të figurojnë në list-pagesat e shoqërisë, është i deklaruar në listpagesat me kodin e profesionit Nr.8332.14 (Shofer kamioni). Në VKM Nr. 514, datë 20.9.2017 “PËR MIRATIMIN E LISTËS KOMBËTARE TË PROFESIONEVE (LKP), TË

RISHIKUAR, është përcaktuar Lista Kombëtare e Profesioneve, ku secilit profesion i korrespondon një kod profesioni i caktuar i veçantë

-Durim Nika -DAP Nr.3136/Nr.serie 00030 e vleshme deri 18.05.2021 per Eskavatoriste (pa firmen e titullarit qe ka leshuar kete deshmi,nuk permban elementet e formës dhe përmbajtjes),figuron ne list-pagesat e shoqërisë me Kodin Nr.8342.03 (Drejtues fadrome/fadromist) të Profesionit sipas (LKP)

Nuk permbush kushtin e kerkuar nga AK si manovrator me dëshmi drejtimi (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse 10-Gjok Sefvgjini –Leje Manovrimi per Automakiniste Nr.303 leshuar nga Shoqata e Ndertueseve te Shqiperise date 29.10.2005, figuron ne list-pagesat e shoqërisë me Kodin Nr.8342.03 (Drejtues fadrome/fadromist) të Profesionit sipas (LKP)

Nuk permbush kushtin e kerkuar nga AK si manovrator me dëshmi drejtimi (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse Do të ishte e vlefshme Leja e manovrimin e rinovuar pranë DPSHTRR që është institucioni i ngarkuar me ligj për këtë qëllim”.

Në bazë të VKM 736, datë 01.07.2009, për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin Nr. 808 datë 04.12.2003 “Për dhënien e lejeve të manovrimin përdoruesve të makinerive të rënda të ndërtimit”, ngarkohet DPSHTRR për pajisjen me Dëshmi Aftësie Profesionale të përdoruesve të makinerive të rënda. Si dhe Në bazë të Urdhërit nr. 200, datë 16.05.2019 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teorike – praktike të kandidatëve si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit” dhe pas plotësimit të kriterëve ligjore nga të interesuarit, kryejmë shërbim për pajisje dhe rinovim për këto lloj dëshmish.

Manvoratore te paraqitur per kualifikim nga OE “K.TURJA” SHPK 11-Dashmir Hoxha -DAP Nr.----- e vleshme deri 14.02.2022 per Eskavatoriste (pa firme dhe vule te titullarit dhe institucinit qe ka leshuar kete deshmi, nuk permban elementet e formës dhe përmbajtjes),figuron ne list-pagesat e shoqërisë me Kodin Nr.8332.06 (Drejtues të makinave të ngjeshjes (rrula)) të Profesionit sipas (LKP)

Nuk permbush kushtin e kerkuar nga AK si manovrator me dëshmi drejtimi (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse 12-Dritan Murati - Leje Manovrimi per Automakiniste Nr.1412 leshua nga Shoqata e Ndertueseve te Shqiperise date 01.06.2009,figuron ne list-pagesat e shoqërisë me Kodin Nr.8332.10 (Drejtues të makinave të shtrimin të rrugëve) të Profesionit sipas (LKP)

Nuk permbush kushtin e kerkuar nga AK si manovrator me dëshmi drejtimi (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse Do të ishte e vlefshme Leja e manovrimin e rinovuar pranë DPSHTRR që është institucioni i ngarkuar me ligj për këtë qëllim”.

Në bazë të VKM 736, datë 01.07.2009, për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin Nr. 808 datë 04.12.2003 “Për dhënien e lejeve të manovrimin përdoruesve të makinerive të rënda të ndërtimit”, ngarkohet DPSHTRR për pajisjen me Dëshmi Aftësie Profesionale të përdoruesve të makinerive të rënda. Si dhe Në bazë të Urdhërit nr. 200, datë 16.05.2019 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet,

kriteret dhe programet për përgatitjen teorike – praktike të kandidatëve si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përoduresit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit” dhe pas plotësimit të kriterëve ligjore nga të interesuarit, kryejmë shërbim për pajisje dhe rinovim për këto lloj dëshmish.

13-Alfred Pali -DAP Nr.----- e vleshme deri 18.12.2019 per Eskavatoriste me zinxhire,figuron ne list-pagesat e shoqërisë me Kodin Nr.8344.01(Drejtues të makinave të rënda me ngritëse) të Profesionit sipas (LKP). Nuk permbush kushtin e kerkuar nga AK si manovrator me dëshmi drejtimi (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse

- *BOE “ALMO KONSTRUKSION” SHPK & “K.TURJA” SHPK per te permbushur KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT per kapacitetin teknik te kerkuara nga AK ne kete procedure prokurimi per piken 16. Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 10). Ku Kerkohen te jene ne dispozicion edhe keto mjete pune,paraqitur per kualifikim nga BOE me te dhenat si me poshte; 1-Eskavator me zinxhire me peshe nga 15-24 ton në pronësi - Shasia Nr. BCN00389- FTSH Nr.29 date 17.02.2009 2-Eskavator me zinxhire me peshe nga 15-24 ton me qira - Shasia Nr.225ML0065- FTSH Nr.60 date 26.12.2007 3-Grejder në pronësi- Shasia Nr.4-11993A -Fature zhdoganimi date 08.08.2001 4-Asfaltoshtruese në pronësi- Shasia Nr.11823000- Fature zhdoganimi Nr.46755 dt. 24.05.2018 5-Asfaltoshtruese në pronësi- Shasia Nr.231137- Fature zhdoganimi Nr.34844 dt. 04.09.2004 6-Rrul me vibrim deri ne 10.5 ton në pronësi Shasia Nr.1906825 -Fature zhdoganimi Nr.56447 dt. 11.10.2006 7-Rrul me vibrim deri ne 10.5 ton në pronësi Shasia Nr.12174628 Fature zhdoganimi Nr.38726 dt. 03.05.2018 8-Rrul me vibrim deri ne 10.5 ton në pronësi Shasia Nr.7HG5695 Fature zhdoganimi Nr.38716 dt. 03.05.2018*

Komisioni i Vleresimit te Ofertave pas verifikimit dhe shqyrtimit te dokumentacionit të parqitur nga BOE “ALMO KONSTRUKSION” SHPK & “K.TURJA” SHPK per te permbushur KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT per kapacitetin teknik te kerkuara nga AK ne kete procedure prokurimi per mjete; konstaton se: Nuk permbushin kushtin e kerkuar nga AK ne DST pika 16.a)dhe b)Per secilën nga mjetetet e mesiperme, kur jane ne pronesi/me qira, duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit lëshuar nga DPSHTRR , leje qarkullimi, çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik dhe siguracioni i vlefshem i mjetit, BOE “ALMO KONSTRUKSION” SHPK & “K.TURJA” SHPK nuk ka paraqitur ne tender gjithë dokumentacionin e nevojshem ligjor te kerkuar ne dokumentat standarte te tenderit per mjetet Eskavator me zinxhire me peshe nga 15-24 ton 2 (dy) cope,Grejder 1(nje) cope,Asfaltoshtruese 2(dy)cope dhe Rrul me vibrim deri ne 10.5 ton 2(dy)cope .Ne lidhje me keto mjete bashkimi i operatoreve ekonomik ,nuk ka paraqitur leje

qarkullimi, siguracion, kolaudim, etj, megjithese te treja mjetet jane levizese ne rruge dhe si te tilla kerkohet detyrimisht te jene te pajisura me leje qarkullimi.

**Në nenin 46, pika 1/b e ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; [...]”*

**Në nenin 26, pika 8/c të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: ç) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”*

**Ndërsa në nenin 26 pika 5 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.*

**Në ligjin Nr.8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 58, pika 1 dhe 1, parashikohet: “1. Makinat teknologjike janë makina vetëlëvizëse ose që tërhiqen, me rrota ose me zinxhirë. Këto makina janë të destinuara të operojnë mbi rrugë dhe në kantiere dhe mund të jenë të pajisura me mekanizma specialë. Këto mjete mund të lëvizin në rrugë për të kaluar nga një vend pune në tjetrin ose për të zhvendosur sende që lidhen me ciklin e punës së vetë makinës ose të kantierit, sipas kufizimeve dhe mënyrave të përcaktuara nga aktet në zbatim. 2. Sipas qëllimeve të qarkullimit rrugor, makinat teknologjike ndahen në: a) makina që përdoren për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e veprave ndërtimore a të infrastrukturës rrugore ose për rivendosjen e trafikut; b) makina që zhbllokojnë rrugën nga bora ose ndihmëse që shpërndajnë rërë a gjëra të këtij lloji; c) motopirunët dhe elektropirunët: mjete të destinuara për lëvizjen e sendeve.” Ndërsa në nenin 113 pika 2 e këtij ligji parashikohet: “2. Për të qarkulluar në rrugë makinat teknologjike duhen regjistruar në zyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, që i lëshojnë lejen e qarkullimit atij që vërteton se është pronari i mjetit.”*

**Në VKM Nr.153 datë 07.04.2000 “Për Miratimin e Rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në nenin 282 “Regjistrimi dhe vendosja e targës e makinave (Neni 113 i Kodit Rrugor)”, pika 1, parashikohet: “1.Makinat, te cilat lejohen të qarkullojnë ne rruge sipas nenit 113 të Kodit Rrugor, duhet*

të regjistrohën pranë degës së DRShtRR-së rrethit përkatës, që merret me nxjerrjen e lejes së qarkullimit dhe të targës të atij që deklarohet pronar i mjetit.”

**Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.*

**Sqarojmë se, referuar legjislacionit të fushës përkatëse, si më sipër cituar, konkretisht Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë dhe VKM Nr.153 datë 07.04.2000 “Për Miratimin e Rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se mjetet e mësipërme duhet të regjistrohën në zyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor të rrethit përkatës, të cilët lëshojnë lejen e qarkullimit për pronarin e mjetit.*

- **Impiant asfalti të paraqitur me kontratë furnizimi Nr.1602 Rep./Nr.588 Kol.dt,04.03.2020 me subjektin “BIBA-X”shpk, me vendndodhje-- Qarku,Elbasan,Rrethi Librazhd,B/F;Qukes,Q/F;Qukes Adresa;ZK 1169 Nr.pasurie 1059/9 Per impiantin e prodhimit të asfaltobetonit paraqitja e planvendosjes me projektin teknologjik me vendndodhje në Qarku,Elbasan,Rrethi Librazhd,B/F;Qukes,Q/F;Qukes Adresa;ZK 1169 Nr.pasurie 1059/9 nuk përmbushin kushtin teknike kerkuar nga AK,vendndodhja e se ciles cila garanton realizimin e objektit konform kushteve teknike,ku per Vendosjen në vepër e përzierjeve të shtresave binder dhe asfaltobetonit, Shpërndarja e përzierjes duhet të bëhet mekanikisht me anën e një makinerie asfalt-shtruese (finitriçe). E gjithë procedura e prodhimit, transportit, vendosjes dhe ngjeshjes së përzierjes nuk lejohet të jetë më shumë se 2 (dy) orë.në zbatim dhe sipas përcaktimve në Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 628, datë 15.7.2015 “Për miratimin e Rregullave Teknike të Projektimit dhe Ndërtimit të Rrugëve”I ndryshuar.*

II.5. Në datën 22.04.2020 BOE ankimes “Almo Konstruksion” shpk & “K.Turja” shpk ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- *Duke qenë të bindur mbi paligjshmërinë të këtij vendimi ju paraqesim këtë ankesë në theks kundërshtimet tona dhe argumentat përkatëse. Gjithashtu ju bëjmë me dije që ankimi ynë do të vijojë të gjitha shkallët e gjyqimit, qoftë edhe atij penal për shkak se duket hapurtendencë për fitues të paracaktuar nga ana juaj me ofertë të barabartë me fondin limit. LPP përcakton rregulla të qarta dhe pasoja po ashtu të qarta për shkelsit e tij.*

- Lidhur me arsyet e skualifikimit për të cilat KVO pretendon se: BOE “ALMO KONSTRUKSION” SHPK & “K.TURJA” SHPK per te permbushur KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT per kapacitetin teknik te kerkuara nga AK ne kete procedure prokurimi per piken 9.Ku Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 13 (trembedhete) manovrate, 9 (nente) shofere, për të cilët duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmitë e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në list-pagesat e shoqërisë, argumentojmë se:
- Në DT në pikën 9 është kërkuar: **9.** Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 13 (trembedhete) manovrate, 9 (nente) shofere, për të cilët duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmitë e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në list-pagesat e shoqërisë.

Për të plotësuar këtë kusht nga ana jonë janë paraqitur:

Kontrata e Punës e vlefshme

Dëshmitë e Drejtimit të vlefshme

Listpagesat përkatëse në të cilat gjenden të siguruar punonjësit e mësipërm:

Idriz Istrefi-eskavatorist- Almo Konstruksion

Shaban Llani-Buldozerist- Almo Konstruksion

Fatos Kuca-Automakinist -Almo Konstruksion

Gëzim Laci- Automakinist- Almo Konstruksion

Fatmir Lozi-Eskavatorist- Almo Konstruksion

Haxhi Gega- Buldozerist- Almo Konstruksion

Alfred Pali- Eskavatorist- Almo Konstruksion

Durim Nika-Eskavatorist- Almo Konstruksion

Sadik Mallunxa- Eskavatorist- Almo Konstruksion

Gjok Sefgjini- Automakinist- Almo Konstruksion

Dashmir Hoxha- Eskavatorist- K.Turja

Dritan Murati- Eskavatorist- K.Turja

Urim Leka- Eskavatorist- K.Turja

Nga ana e KVO-së për një pjesë të tyre është përdorur një argument pa asnjë bazë ligjore por për qëllime të caktuara skualifikimin e shoqërisë sonë. Pretendimi sipas të cilat manovratorët figurojnë në listpagesat e shoqërisë me kode të ndryshme nga

ajo e manovratorit nuk ka asnjë bazë ligjore dhe aq më tepër nuk është kërkuar si kriter në DT.

Së pari sqarojmë që një punonjës ka të drejtë të nënshkruajë një kontratë pune bazuar në Kodin e Punës së RSH-së në një pozicion të caktuar pavarësisht kualifikimeve të tij të cilat janë pjesë e tij pavarësisht punën që kryen në një moment të caktuar. Nëse një punonjës disponon më shumë se një kualifikim ai paguhet pikërisht për atë punë që bën në rastin konkret por në asnjë mënyrë nuk i shfuqizon lejet e drejtimit, kualifikimet apo certifikatat që ai disponon. Punonjësit e mësipërm për të përmbushur kriterin e dhënë nga ana juaj disponojnë dokumentacionin që vërteton kualifikimet si manovratorë të cilat i kemi paraqitur tekstualisht sipas dokumentave të kërkuara nga ana juaj kontrata e punës e vlefshme, dëhsmite e drejtimit të vlefshme si dhe listpagesat përkatëse në të cilat gjenden të siguruar punonjësit e mësipërm.

Në asnjë rast nuk është kërkuar nga ana juaj që në listpagesat e shoqërisë punonjësit të jenë paguar mbi bazën e kodit të manovratorit. Ata dëshmojnë që kanë kualifikimet e kërkuara dhe përmbushin kriterin e dhënë.

Për sa më sipër ky argument i përdorur nga KVO për skualifikim është i paligjshëm dhe bie në kundërshtim me kriteret e dhëna në DT.

- *Lidhur me arsyet e skualifikimit për të cilat KVO pretendon: Nuk përmbushin kushtin e kërkuar nga AK në DST pika 16.a) dhe b) Per secilën nga mjetet e mesiperme, kur janë në pronësi/me qira, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit lëshuar nga DPSHTRR , leje qarkullimi, çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik dhe siguracioni i vlefshëm i mjetit, BOE “ALMO KONSTRUKSION” SHPK & “K.TURJA” SHPK nuk ka paraqitur në tender gjithë dokumentacionin e nevojshëm ligjor të kërkuar në dokumentat standarte të tenderit për mjetet Eskavator me zinxhire me peshe nga 15-24 ton 2 (dy) cope, Grejder 1(nje) cope, Asfaltoshtruese 2(dy)cope dhe Rrul me vibrim deri në 10.5 ton 2(dy)cope .Në lidhje me keto mjete bashkimi I operatoreve ekonomik ,nuk ka paraqitur leje qarkullimi, siguracion, kolaudim, etj, megjithese te treja mjetet jane levizese ne rruge dhe si te tilla kerkohet detyrimisht te jene te pajisura me leje qarkullimi. Argumentojmë se:*

Në DT në pikën 16 është kërkuar:

16.Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 10).

Kerkohen te jene ne dispozicion keto mjete pune:

Nr	Lloji i Makinerive	Perkatesia	Sasia

1	<i>Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 7.5-20 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 4</i>
2	<i>Kamjon me vinc, me kapacitet mbajtës mbi 5 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
3	<i>RTV-Transportier mjete te rrenda</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
4	<i>Kamioncine me kapacitet mbajtës deri ne 1.5 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
5	<i>Fadrome me Goma</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
6	<i>Eskavator me goma me peshe nga 15-24 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
7	<i>Eskavator me zinxhire me peshe nga 15-24 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
8	<i>Grejder</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 3</i>
9	<i>Autobot uji</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
10	<i>Automjet autopompe betoni me krahe</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
11	<i>Autobetoniere</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
12	<i>Automjet vijezi me boje termoplastike me kapacitet jo me te vogel se 4.5 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
13	<i>Asfaltoshtruese</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
14	<i>Rrul me vibrim deri ne 10.5 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>

Kur mjetet jane me qera, duhet të paraqitet kontrata noteriale e qerases (me objektin e prokurimit te percaktuar), dhe bashkëlidhur te gjithë dokumentet e përshkruar me siper. Kontratat e qerases duhet te përfshijnë te gjithë periudhën e realizimit te kontrates dhe te deklarohet qartësisht nga qeradhensi qe mjeti nuk i eshte dhene me qera ndonjë subjekti tjetër per kete kontrate.

- a) Per secilën nga mjetetet e mesiperme, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit lëshuar nga DPSHTRR , leje qarkullimi, certifikata e vlefshme e kontrollit teknik dhe siguracioni i vlefshem i mjetit,*
- b) Kur mjetet jane me qera, duhet të paraqitet kontrata noteriale e qerases (me objektin e prokurimit te percaktuar),. Kontratat e qerases duhet te përfshijnë te gjithë periudhën e realizimit te kontrates dhe te deklarohet qartësisht nga qeradhensi qe mjeti nuk i eshte dhene me qera ndonjë subjekti tjetër per kete kontrate*

Per mjetet e siguruara me qera bashkëlidhur duhet te jene dokumenti qe verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(te vlefshme) si dhe Çertifikatën për transport mallrash, duhet te shoqerohet me

kontraten perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi.

- c) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- d) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimin e deklarimit).*

Për të plotësuar këtë kusht nga ana jonë janë paraqitur mjetet e mësipërme të shoqëruara me dokumentacionin e ligjshëm që administrata shqiptare lëshon për këto mjete. Kështu Eskavator me Zinxhirë (pavarëisht nga peshja) Grejderat, Asfaltshtrueset dhe Rrulat nuk janë mjete që shënohen në rregjistra publikë, nuk janë mjete që qarkullojnë në rrugë, por në kantiere ndërtimi dhe si të tilla nuk shoqërohen me leje qarkullimi, certifikata të vlefshme të kontrollit teknik dhe siguracion. Këto mjete sigurohen si mjete kantjeri.

Në Ligjin nr.8378 datë 22.07.1998 Kodi Rrugor i RSH neni 58 pika 1 parashikohet:

- 1. Makinat teknologjike janë makina vetëlëvizëse ose që tërhiqen, me rrota ose me zinxhirë. Këto makina janë të destinuara të operojnë mbi rrugë dhe në kantiere dhe mund të jenë të pajisura me mekanizma specialë. Këto mjete mund të lëvizin në rrugë për të kaluar nga një vend pune në tjetrin ose për të zhvendosur sende që lidhen me ciklin 80 e punës së vetë makinës ose të kantierit, sipas kufizimeve dhe mënyrave të përcaktuara nga aktet në zbatim. 2. Sipas qëllimeve të qarkullimit rrugor, makinat teknologjike ndahen në: a) makina që përdoren për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e veprave ndërtimore a të infrastrukturës rrugore ose për rivendosjen e trafikut; b) makina që zhbllkojnë rrugën nga bora ose ndihmëse që shpërndajnë rërë a gjëra të këtij lloji; c) motopirunët dhe elektropirunët: mjete të destinuara për lëvizjen e sendeve.*

Ndërsa në nenin 113 pika 2 e këtij ligji parashikohet : 2. Për të qarkulluar në rrugë makinat teknologjike duhen regjistruar në zyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, që i lëshojnë lejen e qarkullimit atij që vërteton se është pronari i mjetit

Në VKM nr.153 datë 07.04.2000 “Për miratimin e Rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të RSH të ndryshuar në nenin 282 “Regjistrimi dhe vendosja e targës e makinave (Neni 113 i Kodit Rrugor) pika 1 parashikohet:

- Makinat, te cilat lejohen të qarkullojnë ne rruge sipas nenit 113 të Kodit Rrugor, duhet të regjistrohen prane deges se DRShTRr-se rrethit përkatës, që merret me nxjerrjen e lejes se qarkullimit dhe të targes të atij që deklarohet pronar i mjetit.*

Baza ligjore e mësipërme por edhe udhëzimi nr.2 datë 11.03.2010 “Mbi Kontrollin Teknik të Mjeteve Rrugore” përcaktojnë edhe detyrimin e kontrollit teknik “Te gjitha mjetet rrugore që rregjistrohen dhe qarkullojnë në RSH i nënshtrohen kontrollit teknik

të detyrueshëm. Pra që një mjet të qarkullojë në rrugë duhet detyrimisht ti nënshtrohet kontrollit teknik.

Neni 58 i Kodit Rrugor në pikën 1 përcakton: 1. Makinat teknologjike janë makina vetëlëvizëse ose që tërhiqen, me rrota ose me zinxhirë. Këto makina janë të destinuara të operojnë mbi rrugë dhe në kantiere dhe mund të jenë të pajisura me mekanizma specialë. Këto mjete mund të lëvizin në rrugë për të kaluar nga një vend pune në tjetrin ose për të zhvendosur sende që lidhen me ciklin 80 e punës së vetë makinës ose të kantierit, sipas kufizimeve dhe mënyrave të përcaktuara nga aktet në zbatim.

Nga ky nen kuptojmë të drejtën për të lëvizur një mjet në rrugë , jo qarkullimin e tij dhe kjo e drejtë që miratohet duhet të plotësojë një sërë kushtesh që jepen në vijim, VKM-në apo udhëzimet përkatëse. Pra në tërësi në zbatim të Kodit Rrugor makinat teknologjike nuk qarkullojnë në rrugë por lejohet të lëvizin sipas nevojave. Në kushtet kur nuk ushtrohet kjo e drejtë për lëvizje të mjeteve në mënyrë të pavarur, por nëpërmjet rimorkiove këto mjete nuk shënohen në regjistra publikë, nuk i nënshtrohen kontrollit teknik dhe nuk kanë leje qarkullimi. Vetëm në raste të vecanta kur vetë subjekti e ushtron këtë të drejtë duke plotësuar disa kushte mund të jepet e drejta e lëvizjes në rrugë. AK-ja nuk mund të kërkojë dokumente që subjekte të caktuara i përfitojnë mbi bazën e një të drejte por dokumente që janë detyrim ligjor. Për këto mjete Eskavator me Zinxhirë (pavarëisht nga peshja) Grejderat, Asfaltshtrueset dhe Rrulat, nuk është detyrim ligjor pajisja me lejen e qarkullimit, , certifikata të vlefshme të kontrollit teknik dhe siguracion pasi nuk janë mjete që qarkullojnë në rrugë por në kantiere ndërtimi.

Kriteri i vënë nga ana juaj përvecse i paligjshëm pasi nuk janë përcaltuar dokumentet ligjore po ato dokumente që ka pasur fituesi i paracaktuar nga ana juaj janë zbatuar po në mënyrë të paligjshme nga KVO me qëllim përmbylljen e tërë ciklit korruptiv.

Sa më sipër kriteri është plotësuar nga ana jonë dhe vlerësimi nga KVO është i paligjshëm.

- Lidhur me arsyet e skualifikimit për të cilat KVO pretendon Impiant asfalti te paraqitur me kontrate furnizimi Nr.1602 Rep./Nr.588 Kol.dt,04.03.2020 me subjektin "BIBA-X"shpk, me vendndodhje- Qarku, Elbasan, Rrethi Librazhd, B/F;Qukes,Q/F; Qukes Adresa;ZK 1169 Nr.pasurie 1059/9

Per impiantin e prodhimit te asfaltobetonit paraqitja e planvendosjes me projektin teknologjik me vendndodhje ne Qarku, Elbasan, Rrethi Librazhd, B/F;Qukes,Q/F; Qukes Adresa; ZK 1169 Nr.pasurie 1059/9 nuk permbushin kushtin teknike kerkuar nga AK, vendndodhja e se ciles cila garanton realizimin e objektit konform kushteve teknike, ku per Vendosjen në vepër e përzierjeve te shtresave binder dhe asfaltobetonit, Shpërndarja e përzierjes duhet të bëhet mekanikisht me anën e një makinerie asfalt-shtruese (finitriçe).

E gjithë procedura e prodhimit, transportit, vendosjes dhe ngjeshjes së përzierjes nuk lejohet të jetë më shumë se 2 (dy) orë.ne zbatim dhe sipas percaktimve ne

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 628, datë 15.7.2015 “Për miratimin e Rregullave Teknike të Projektimit dhe Ndërtimit të Rrugëve” I ndryshuar.

Argumentojmë se:

Konkluzioni i dhënë nga KVO vendndodhja e se ciles cila garanton realizimin e objektit konform kushteve teknike, përvec se shumë qesharak është dhe i paligjshëm duke i ngarkuar me përgjegjësi ligjore zyrtarët që e kanë dhënë. Vendodhja e fabrikës së asfaltobetonit nuk ndikon në realizimin sipas kushteve teknike të objektit të kontratës por cilësia e tij. AK nëpërmjet mbikqyrësit ose vetë si investitor ose dhe kolaudatorët të kontraktuar nga ai janë subjekte ligjore përgjegjëse për veprën. Nëse ajo nuk do të jetë në kushtet teknike të kërkuara të mospranohet. KVO nuk mund të vlerësojë dokumentet përvecse sipas kritereve të dhëna në DT. Në to nuk është përcaktuar asnjë kriter në lidhje me largësinë nga vendi objekt i kontratës.

Sa më sipër rezulton që kërkesa e dhënë plotësohet tërësisht dhe kjo arsye skualifikimi nuk qëndron.

Po të bësh një llogaritje të ofertës së renditur në vend të parë nga ana e AK me ofertën e paraqitur nga BOE jonë rezulton që ka një diferencë të theksuar me vlerë 21,747,055 lekë. KVO ka shkaktuar një dëm ekonomik me vlerë 21,747,055 lekë.

Sa më sipër kërkojmë: Kualifikimin e ofertës së paraqitur nga ana jonë si oferta më e favorshme me vlerë më të ulët.

II.6. Në datën 23.04.2020 me shkresën nr. 1017/3 prot bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “Almo Konstruksion” shpk & “K.Turja” shpk, është vënë në dijeni në lidhje me mospranimin e ankesës nga autoriteti kontraktor.

II.7. Në datën 30.04.2020 bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese drejtuar autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr.1091/2 prot datë 08.05.2020 protokolluar me tonën me nr.366/2 prot datë 14.05.2020 me objekt “Dërgohet informacioni”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Në lidhje me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Almo Konstruksion” shpk & “K.Turja” shpk për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tyre me arsyetimin “Pas verifikimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit të parqitur nga BOE “ALMO KONSTRUKSION” SHPK & “K.TURJA” SHPK për të përmbushur KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT për kapacitetin teknik të kerkuara nga AK në këtë procedurë prokurimi për piken 9.Ku Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 13 (trembedhjetë) manovratore, 9 (nëntë) shofere, për të cilët duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmitë e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në list-pagesat e shoqërisë. konstaton se:

BOE “ALMO KONSTRUKSION” SHPK & “K.TURJA” SHPK nuk plotëson kapacitetin teknik sipas pikës 9 të DST: 1. Mungojnë 5 (pese) manovratore, për të cilët duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmitë e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në list-pagesat e shoqërisë. Manvratore të paraqitur për kualifikim nga OE “ALMO KONSTRUKSION” SHPK 2-Gezim Laçi -DAP Nr.2066/Nr.serie 01641 e vlefshme deri 12.12.2024 për Automakiniste, figuron në list-pagesat e shoqërisë me Kodin Nr.8332.14 (Shofer kamioni) të Profesionit sipas (LKP)

Nuk përmbush kriterin e kualifikimit kerkuar nga AK në DST si manovrator të figurojnë në list-pagesat e shoqërisë, është i deklaruar në listpagesat me kodin e profesionit Nr.8332.14 (Shofer kamioni). Në VKM Nr. 514, datë 20.9.2017 “PËR MIRATIMIN E LISTËS KOMBËTARE TË PROFESIONEVE (LKP), TË RISHIKUAR, është përcaktuar Lista Kombëtare e Profesioneve, ku secilit profesion i korrespondon një kod profesioni i caktuar i veçantë 8-Durim Nika -DAP Nr.3136/Nr.serie 00030 e vlefshme deri 18.05.2021 për Eskavatoriste (pa firmen e titullarit që ka lëshuar këtë dëshmi, nuk përmban elementet e formës dhe përmbajtjes), figuron në list-pagesat e shoqërisë me Kodin Nr.8342.03 (Drejtues fadrome/fadromist) të Profesionit sipas (LKP)

Nuk përmbush kushtin e kerkuar nga AK si manovrator me dëshmi drejtimi (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse 10-Gjok Sefvgjini –Leje Manovrimi për Automakiniste Nr.303 lëshuar nga Shoqata e Ndertuesëve të Shqiperisë date 29.10.2005, figuron në list-pagesat e shoqërisë me Kodin Nr.8342.03 (Drejtues fadrome/fadromist) të Profesionit sipas (LKP)

Nuk përmbush kushtin e kerkuar nga AK si manovrator me dëshmi drejtimi (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse Do të ishte e vlefshme Leja e manovrimit e rinovuar pranë DPSHTRR që është institucioni i ngarkuar me ligj për këtë qëllim”.

Në bazë të VKM 736, datë 01.07.2009, për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin Nr. 808 datë 04.12.2003 “Për dhënien e lejeve të manovrimit përdoruesve të makinerive të rënda të ndërtimit”, ngarkohet DPSHTRR për pajisjen me Dëshmi Aftësie Profesionale të përdoruesve të makinerive të rënda. Si dhe Në bazë të Urdhërit nr. 200, datë 16.05.2019 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teorike – praktike të kandidatëve si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përoduerit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i

përdorimit të makinerive të ndërtimit” dhe pas plotësimit të kriterëve ligjore nga të interesuarit, kryejmë shërbim për pajisje dhe rinovim për këto lloj dëshmish.

Manvororesh të paraqitura për kualifikim nga OE “K.TURJA” SHPK 11-Dashmir Hoxha - DAP Nr.----- e vleshme deri 14.02.2022 për Eskavatoriste (pa firmë dhe vule të titullarit dhe institucionit që ka leshuar këtë dëshmi, nuk përmban elementet e formës dhe përmbajtjes), figuron në list-pagesat e shoqërisë me Kodin Nr.8332.06 (Drejtues të makinave të ngjeshjes (rrula)) të Profesionit sipas (LKP)

Nuk përmbush kushtin e kërkuar nga AK si manvror me dëshmi drejtimi (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse 12-Dritan Murati - Leje Manovrimi për Automakiniste Nr.1412 leshua nga Shoqata e Ndertueseve të Shqipërisë date 01.06.2009, figuron në list-pagesat e shoqërisë me Kodin Nr.8332.10 (Drejtues të makinave të shtrimit të rrugëve) të Profesionit sipas (LKP)

Nuk përmbush kushtin e kërkuar nga AK si manvror me dëshmi drejtimi (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse Do të ishte e vlefshme Leja e manovrimit e rinovuar pranë DPSHTRR që është institucioni i ngarkuar me ligj për këtë qëllim”.

Në bazë të VKM 736, datë 01.07.2009, për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin Nr. 808 datë 04.12.2003 “Për dhënien e lejeve të manovrimit përdoruesve të makinerive të rënda të ndërtimit”, ngarkohet DPSHTRR për pajisjen me Dëshmi Aftësie Profesionale të përdoruesve të makinerive të rënda. Si dhe Në bazë të Urdhërit nr. 200, datë 16.05.2019 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teorike – praktike të kandidatëve si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përoduesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit” dhe pas plotësimit të kriterëve ligjore nga të interesuarit, kryejmë shërbim për pajisje dhe rinovim për këto lloj dëshmish.

13-Alfred Pali -DAP Nr.----- e vleshme deri 18.12.2019 për Eskavatoriste me zinxhire, figuron në list-pagesat e shoqërisë me Kodin Nr.8344.01(Drejtues të makinave të rënda me ngritëse) të Profesionit sipas (LKP).

Nuk përmbush kushtin e kërkuar nga AK si manvror me dëshmi drejtimi (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse “, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Almo Konstruksion” shpk dhe “K.Turja“ shpk kanë krijuar bashkimin e përkohshëm të operatorëve ekonomikë nëpërmjet Akt Marrëveshjes nr.1748 rep nr.652 kol datë 11.03.2020 për realizimin e objektit ‘Zgjerimi i Rrugës Vendore, Aks Superstrada e Devollit- Ismail Qemali, Demir Progeri-Aks Rrg. Etem Osman Xhaci dhe Rehabilitim i Rrugeve Vendore Lagjia Nr. 2 dhe Lagjia Nr. 3”, Përqindja e kryerjes së punimeve sipas marrëveshjes do të jetë “Almo Konstruksion” shpk 93% të investimit dhe shoqëria “K.Turja” shpk 7% të investimit sipas sasisë të zërave të preventivit të punimeve bashkëngjitur.

III.1.2. Në shtojcën 12 “Kriteret e vecanta të kualifikimit” pika 2.3.9 “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

- Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 13 (trembedhjetë) manvororesh, 9 (nëntë) shofere, për të cilët duhet të paraqitet kontrata e punës e

vlefshme, dëshmitë e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në list-pagesat e shoqërisë.

III.1.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se BOE ankimues “Almo Konstruksion” shpk & “K.Turja” shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër kanë dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Kontratë Individuale Pune datë 01.12.2019 lidhur ndërmjet Shoqëria “Almo Konstruksion” shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe Idriz Istrefi në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin e Manovrator-shofer, Dëshmi Aftësie Profesionale Për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë Nr.372 lëshuar nga DPSHTRR lëshuar më 14.04.2017 e vlefshme deri në 13.04.2022, Leje Drejtimi.
- Kontratë Individuale Pune datë 01.12.2019 lidhur ndërmjet Shoqëria Almo Konstruksion shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe Gëzim Laci në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin e Manovrator-shofer, Dëshmi Aftësie Profesionale Për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë Nr. regj 2066, lëshuar nga DPSHTRR lëshuar më datë 13.12.2019 e vlefshme deri në 12.12.2024, Leje Drejtimi.
- Kontratë Individuale Pune datë 01.12.2019 lidhur ndërmjet Shoqëria Almo Konstruksion shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe Shaban Llani në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin e Manovrator-shofer, Dëshmi Aftësie Profesionale Për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë Nr. 563 lëshuar nga DPSHTRR lëshuar më datë 17.08.2016 e vlefshme deri në 16.08.2021, Leje Drejtimi.
- Kontratë Individuale Pune datë 01.12.2019 lidhur ndërmjet Shoqëria Almo Konstruksion shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe Fatos Kuca në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin e Manovrator-shofer, Dëshmi Aftësie Profesionale Për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë Nr. regj 2063, lëshuar nga DPSHTRR lëshuar më datë 13.12.2019 e vlefshme deri në 12.12.2024, Dëshmi Aftësie Profesionale Për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë Nr.374 lëshuar nga DPSHTRR lëshuar më datë 14.04.2017 e vlefshme deri në 13.04.2022, Leje Drejtimi.
- Kontratë Individuale Pune datë 01.12.2019 lidhur ndërmjet Shoqëria Almo Konstruksion shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe Fatimir Lozi në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin e Manovrator-shofer, Dëshmi Aftësie Profesionale Për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë Nr.2935 lëshuar nga DPSHTRR lëshuar më datë 05.04.2016 e vlefshme deri në 04.04.2021
- Kontratë Individuale Pune datë 02.03.2020 lidhur ndërmjet Shoqëria Almo Konstruksion shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe Haxhi Gega në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin e Manovrator-shofer. Dëshmi Aftësie Profesionale Për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë Nr.354 lëshuar nga DPSHTRR lëshuar më datë 08.01.2016 e vlefshme deri në 07.01.2021, Dëshmi Aftësie Profesionale Për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe

punimeve në tokë Nr.353 lëshuar nga DPSHTRR lëshuar më datë 08.01.2016 e vlefshme deri në 07.01.2021, Leje Drejtimi.

- Kontratë Individuale Pune datë 02.03.2020 lidhur ndërmjet Shoqëria Almo Konstruksion shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe Alfred Pali në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin e Manovrator-shofer, Dëshmi Aftësie Profesionale Për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë Nr.3002 lëshuar nga DPSHTRR lëshuar më datë 06.04.2016 e vlefshme deri në 05.04.2021.
- Kontratë Individuale Pune datë 02.03.2020 lidhur ndërmjet Shoqëria Almo Konstruksion shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe Durim Nika në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin e Manovrator-shofer, Dëshmi Aftësie Profesionale Për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë Nr.3136 lëshuar nga DPSHTRR lëshuar më datë 19.05.2016 e vlefshme deri në 18.05.2021. (rezulton pa firmë të titullarit).
- Kontratë Individuale Pune datë 02.03.2020 lidhur ndërmjet Shoqëria Almo Konstruksion shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe Sadik Mallunxa në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin e Manovrator-shofer, Dëshmi Aftësie Profesionale Për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë Nr.1410 lëshuar nga DPSHTRR lëshuar më datë 27.05.2019 e vlefshme deri në 26.05.2024.
- Kontratë Individuale Pune datë 02.03.2020 lidhur ndërmjet Shoqëria Almo Konstruksion shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe Gjok Sefgjini në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin e Manovrator-shofer, Leje Manovrimi për Automakinistë Nr. 303 lëshuar nga Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë në 29.10.2005.

- Kontratë Individuale e Punës datë 03.01.2019 lidhur ndërmjet shoqëria K.Turja në cilësinë e punëdhënësit dhe Dashmir Hoxha në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin Manovrator, Dëshmi Kualifikimi e Sigurimit Teknik Dt e lëshimit e fundit 03.05.2019- dt e skadencës 02.05.2020, fleta e dytë e dëshmisë së aftësisë profesionale Nr.593 datë 15.02.2017 lëshuar nga DPSHTRR për eskavatoristë, Dt e lëshimit 15.02.2017 e vlefshme deri në 14.02.2022 pa firmë dhe vulë.
- Kontratë Individuale e Punës datë 03.01.2019 lidhur ndërmjet shoqëria K.Turja në cilësinë e punëdhënësit dhe Dritan Murati në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin Manovrator, Dëshmi Kualifikimi e Sigurimit Teknik Dt e lëshimit e fundit 03.05.2019- dt e skadencës 02.05.2020, Leje Manovrimi Për Automakinistë Nr.1412 lëshuar nga Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë datë 01.06.2009.
- Kontratë Individuale e Punës datë 03.01.2019 lidhur ndërmjet shoqëria K.Turja në cilësinë e punëdhënësit dhe Gersian Metani në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin e Manovrator, Dëshmi Kualifikimi e Sigurimit Teknik Dt e lëshimit e fundit 03.05.2019- dt e skadencës 02.05.2020, fleta e dytë e dëshmisë së aftësisë profesionale Nr.1774 datë 13.12.2014 lëshuar nga DPSHTRR për eskavatoristë me zinxhir, Data e lëshimit 19.12.2014 e vlefshme deri në 18.12.2019 e firmosur pa vulë.
- Kontratë Individuale Pune datë 03.01.2019 lidhur ndërmjet shoqëria K.Turja në cilësinë e punëdhënësit dhe Urim Leka ne cilësinë e punëmarrësit në pozicionin e

Manovrator, Dëshmi Kualifikimi e Sigurimit Teknik Dt e lëshimit e fundit 03.05.2019- dt e skadencës 02.05.2020, Dëshmi Aftësie Profesionale Për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë Nr.306 lëshuar nga DPSHTRR lëshuar më datë 14.11.2017 e vlefshme deri më 13.11.2022.

III.1.4. Në Kreun VIII (“Kushte të përgjithshme për zbatim”), neni 74 (“Bashkimi i operatorëve ekonomikë”), pika 1, dhe 3 të VKM 914/2014 i ndryshuar parashikohet se :

“1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.....

2. Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. Në rast se bashkimi I operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.

“3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.”.

III.1.5. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”

III.1.6. Në nenin 26 pika 8 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt I kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;dhe/ose

b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomikë nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;dhe/ose

c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

III.1.7. Komisioni referuar dokumentacionit sa më sipër të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues në përmbushje të kriterit kualifikues lidhur me numrin e punonjësve të punësuar si manovratorë konstaton se anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Almo Konstruksion” sh.p.k referuar marrëveshjes së bashkëpunimit ka marrë përsipër kryerjen e 93 % të zërave të preventivit. Operatori ekonomik “Almo Konstruksion” sh.p.k referuar përqindjes së marrë përsipër duhet të dëshmonte me anë të dokumentacionit se disponon një numër prej 12 punonjësish të kontraktuar si manovratorë. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të paraqitur nga ankimuesi, Komisioni konstaton se numri i manovratorëve të kontraktuar nga shoqëria “Almo Konstruksion” shpk është 10 punonjës. Përpos kësaj rezulton i drejtë konstatimi i autoritetit kontraktor lidhur me manovratorin Durim Nika i cili ka paraqitur dëshmi të aftësisë profesionale që nuk përmban elementët formalë të vlefshmërisë sikundër firma e titullarit të institucionit që e ka lëshuar duke e ulur numrin e punonjësve të pajisur me dëshmi profesionale të vlefshme në 9. Në këtë kuptim Komisioni gjykon se anëtari i bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Almo Konstruksion” shpk i cili ka përqindjen më të madhe në këtë bashkim, është në kushtet e mospërmbushjes së kriterit të vecantë të kualifikimit lidhur me numrin e nevojshëm të manovratorëve të kërkuar në kriterin e vecantë të kualifikimit pasi numri i manovratorëve që ai disponon është më i vogël se ai që duhet të plotësohej referuar VKM nr.914 datë 29.12.2014 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e cila në nenin 74 pika 3 e cila parashikon shprehimisht se: ”Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.

III.1.8. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se me anë të kriterit të mësipërm, qëllimi i autoritetit kontraktor është vërtetimi se anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë, në përputhje me nenin 74 pika 3 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar disponojnë stafin e nevojshëm (fuqinë punëtore) në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Me anë të dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Almo Konstruksion” sh.p.k nuk ka vërtetuar se disponon manovratorët e nevojshëm të

kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor në përputhje me përqindjen e marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit.

III.1.9. Komisioni gjykon se përmbushja e kriterëve ekonomike, teknike, profesionale në rastin konkret është një detyrim që buron nga ligji i cili në mënyrë taksative kërkon përmbushjen e tyre nga të gjithë anëtarët e bashkimit. Ndarja në përqindje e kontributit dhe në terma konkretë të punëve për secilin anëtar të bashkimit nëpërmjet aktmarrëveshjes bëhet pikërisht në funksion të përmbushjes së kriterëve në atë masë apo në proporcion me atë që operatori ekonomik ka marrë përsipër të kryejë për realizimin me sukses të kontratës.

Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Almo Konstruksion” shpk & “K.Turja” shpk nuk është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi kriteri për disponimin e stafit të nevojshëm për realizimin e kontratës në rastin konkret manovratorë nuk është plotësuar në mënyrë të plotë nga anëtari i këtij bashkimi “Almo Konstruksion” shpk duke mos qenë në përputhje me përqindjen e marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit.

Sa më sipër pretendimi i BOE ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet mbi arsyet e tjera të skualifikimit të BOE ankimues “Almo Konstruksion” shpk & “K.Turja” shpk Komisioni i Prokurimit Publik, referuar gjyqimit mësipër gjykon se nuk do të merren në shqyrtim për ekonomi të procedurës administrative pasi, gjendja faktike dhe juridike e bashkimit të operatorëve ekonomikë do të vijojë të ngelet e skualifikuar edhe pas ankimit në KPP, duke mos pasur më interes të ligjshëm në lidhje me këtë procedurë prokurimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga BOE “Almo Konstruksion” shpk & “K.Turja” shpk për procedurën e prokurimit, “*Procedurë e Hapur*”, me nr.REF-49839-02-07-2020, me objekt ‘*Zgjerimi i Rrugës Vendore, Aks Superstrada e Devollit- Ismail Qemali, Demir Progeri-Aks Rrg. Etem Osman Xhaci dhe Rehabilitim i Rrugeve Vendore Lagjia Nr. 2 dhe Lagjia Nr. 3*’, me fond limit 83 333 963 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 27.03.2020 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Devoll.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 366 Protokoll; Datë 30.04.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha